

**ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS**

---

*RAPORTI*

**I REGJISTRIMIT TESTUES  
27 TETOR - 10 NËNTOR 2008**

Prishtinë dhjetor, 2008

## *Përmbajtja*

Parathënie.....	3
Hyrje.....	4
Qëllimi i regjistrimit testues.....	5
Përgatitjet e përgjithshme – materialet.....	5
Formularët.....	6
Udhëzuesit -doracaket.....	7
Hartat.....	7
Mostra e përzgjedhur.....	7
Aspekti Logjistikë.....	9
Fushata sensibilizuese.....	9
Trajnimet.....	11
TI-përfshirja.....	11
Monitorimi.....	15
Aktivitete tjera - Hapësira punuese.....	16
Azhurnim i hartave dhe GIS.....	16
Konkluzionet .....	16
Rekomandimet.....	16
Regjistrimi i përgjithshëm në vitin 2009.....	18

## **Parathënie**

Ky Raport Final i përgatitur nga ESK ofron një përmbledhje të aktiviteteve kryesore të Regjistrimit Testues që është mbajtur gjatë periudhës 27 tetor deri me 10 nëntor 2008, që është zhvilluar në 6 komuna të Kosovës (Prishtine, Prizren, Dragash, Mamushë, Lipjan dhe Vushtrri).

Raporti paraqet fazat e rëndësishme që janë ndërmarr me qëllim të realizimit me sukses të regjistrimit testues, pa hyrë në detaje lidhur me aktivitetet e ndryshme me të cilat Enti i Statistikës së Kosovës është marrë në fazat e mëhershme, pasi që ato janë raportuar me herët.

Raporti është përgatitur në bazë të raporteve të marrura nga personeli angazhuar në regjistrimin testues si kontrolloret, mbikëqyrësit dhe anëtarët e komisioneve komunale të regjistrimit.

Qëllimi i këtij raporti është informimi i Qeverisë së Kosovës, MSHP, Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe Organizatave Ndërkombëtare (duke përfshirë edhe EUROSTAT-in) lidhur me ecurinë e regjistrimit testues - rezultatet dhe përgatitjet - për regjistrimin e rregullt të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Raporti elaboron dhe do të jap disa rekomandime duke iu referuar të gjeturave si dhe mundësinë e koordinimit në mes të ESK, Komisionit Qendror të Regjistrimit, MSHP, Qeverisë së Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare, për të marrë hapa konkret nga të gjeturat e këtij regjistrimi testues, që njëherit ka qenë edhe qëllimi i realizimit të tij. Po ashtu synimi i të gjeturave nga ky raport është që të ndihmojnë në sigurimin që regjistrimi i plotë i popullsisë të jetë i suksesshëm.

## Hyrje

Që nga viti 1981 në Kosovë nuk ka pasur regjistrim të popullsisë. Sipas Ligjit mbi regjistrimin e popullsisë (dhe sipas praktikave ndërkombëtare) regjistrimin e popullsisë e realizojnë Zyrrat Shtetërore të Statistikës.

Pas aprovimit të Ligjit mbi regjistrimin e popullsisë (2003), Enti i Statistikave të Kosovës ka ngritur Zyrrën për regjistrimin e popullsisë dhe ka filluar përgatitjet për regjistrim.

Gjatë vitit 2005 (tetor) ESK ka realizuar regjistrimin e parë testues. Ky regjistrim nuk është monitoruar nga organizatat ndërkombëtare që monitorojnë regjistrimin e popullsisë në Kosovë dhe njeherit është vlerësuar se nuk ka pasur harmonizim të formularëve dhe instrumenteve tjera të domosdoshme me rekomandimet ndërkombëtare për regjistrim.

Nga muaji mars 2006 - korrik 2008, ESK ka pasur mbështetje teknike të financuar nga AER. Projekti është realizuar nga konsorciumi i përberë prej: ISTAT-it, INSTAT-it dhe Universiteti La Sapienza të Romës.

Pas standardizimit të instrumenteve sipas rekomandimeve ndërkombëtare për regjistrime dhe pranimit të tyre nga ana e Komisionit Drejtues Monitorues, ESK ka realizuar regjistrimin e dytë testues që është zhvilluar në muajin nëntor 2006. ESK gjatë kësaj periudhe në të gjitha fazat e përgatitjeve për regjistrim deri tek analizat ka pasur mbështetje teknike dhe monitorim të regjistrimit testues.

Për shkak të mos participimit të komunitetit serb dhe një pjese të komunitetit romë (në regjistrimin testues 2006) dhe me qëllim të testimit të të gjitha instrumenteve, në raportin e Komisionit Drejtues të Organizatave Ndërkombëtare<sup>1</sup> i'u është rekomanduar ESK-se të realizoi edhe një regjistrim testues me përmasa më të vogla (minor) para regjistrimit të përgjithshëm.

Pas diskutimeve të ESK me KD<sup>2</sup> dhe në konsultim me përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Regjistrimit (KQR) për të zhvilluar edhe një regjistrim Testues është propozuar që ai të mbahet në vjeshtë duke përfshirë monitorimin ndërkombëtar.

Regjistrimi i tretë testues është zhvilluar nga 27 tetori deri 10 nëntor 2008 (kohëzgjatja në terren ishte dy javë - duke përfshirë edhe ditët e vikendeve).

---

<sup>1</sup> Faqe, 13 nga Raporti i KD 17-19 korrik, **2007** - Kryerja e aktiviteteve të rëndësishme në Fazën e Dytë

<sup>2</sup> Komisioni Drejtues Monitorues (EURSOTAT-it)

## **Qëllimi i regjistrimit testues**

Pas regjistrimit pilot të mbajtur në nëntor 2006 dhe pas të gjeturave që janë identifikuar, dhe vlerësimit (nga ESK dhe KD) është parë e nevojshme që të bëhen disa ndryshime në pyetësor, harta dhe programin për futjen e të dhënave e sidomos për shkak të mos participimit të komunitetit serb dhe një pjese të komunitetit romë (që kishin bojkotuar pjesëmarrjen në regjistrimin pilot 2006), iu është kërkuar ESK-se, nga ana e Komisioni Drejtues i Operacionit Monitorues Ndërkombëtare që të zhvilloi edhe një mini-testim në terren për të testuar variantin e rishikuar të pyetësorëve, duke i përfshirë ndryshimet e bëra në bazë të rezultateve të Regjistrimit pilot 2006 dhe disa ndryshimeve të vogla të miratuara nga KD, pas modifikimit të instrumenteve statistikore.

Është kërkuar nga ESK që përfaqësimi e i komuniteteve jo shqiptare në mostrën e përzgjedhur në regjistrimin testues të ishte më i madh se sa numri që ata përfaqësojnë komunitetin e tyre në Kosovë.

Regjistrimi testues kishte për qëllim t'i vlerësoj aspektet më të rëndësishme të regjistrimit, duke filluar prej koncepteve dhe definicioneve të përdorura, formulimeve të pyetjeve në pyetësor, metodologjinë e regjistrimit, trajnimit të regjistruesve, punës në terren, personelit mbikëqyrës, organizimin e logjistikës, sensibilizimit, funksionimin e Komisioneve Komunale, procedimin e të dhënave - programit si dhe procedurën e tabelimit të të dhënave.

Po ashtu janë testuar nëse burimet njerëzore të kërkuara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme janë adekuate sipas planifikimeve ku njëherit rezultatet e regjistrimit testues do të përdoren për t'i përgatitur planet detale ose përfundimtare për regjistrimin e përgjithshëm.

## **Përgatitjet e përgjithshme - materialet**

Duke u bazuar se Regjistrimi i përgjithshëm do të zhvillohet në pranverë të vitit 2009, ESK kishte propozuar fillimin e muajit tetor për zhvillimin e Testit me qëllim që të ketë kohë në realizimin e aktiviteteve tjera të rëndësishme për regjistrimin e përgjithshëm.

Pas takimit të mbajtur (shtator 2008) në mes të ESK dhe Përfaqësuesve të Komitetit Drejtues Ndërkombëtar, është kërkuar nga këta të dytë që regjistrimi testues të shtyhet për fund të muajit tetor duke marrë në konsideratë kohën më optimale për monitorim ndërkombëtar. Pas konsultimeve që ka pasur ESK me anëtarët e Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe insistimit nga ana e Komisionit Drejtues është caktuar që regjistrimi të zhvillohet nga 27 tetori deri më 10 nëntor 2008.

Po ashtu KD kishte kërkuar që sipas mundësisë në disa Qarqe Regjistruese, regjistrimi të mbaroj brenda 10 ditëve gjë që ESK e ka parë si të mundshme dhe të realizueshme njëherit ka zbatuar kërkesën e KDM.

Pas pajtimit nga ana e: KQR, ESK dhe KD-es për kohën (datën) e zhvillimit të testit dhe mostrën, kishin filluar përgatitjet intensive për të gjitha aktivitetet. Është përgatitur plani i punës si dhe janë përcaktuar detyrat e secilit grup punues dhe personelit tjetër pjesëmarrës në regjistrimin testues.

Funksionimi i Komisioneve Komunale të regjistrimit, përzgjedhja e regjistrueseve dhe personelit tjetër, përgatitja e instrumenteve të ndryshme (formularëve, udhëzueseve, hartave, pajisjeve tjera), mbajtja e trajnimeve, dinamika e zhvillimit të fushatës sensibilizuese, aspekti logjistike si dhe realizimi i punëve në terren, ishin në nivel të avancuar krahasuar me regjistrimet pilote të mëparshme dhe kishin funksionuar sipas planit dinamik që ishte përgatitur më parë nga ESK.

ESK kishte përgatitur me kohë të gjitha materialet e nevojshme të cilat janë përgatitur në 4 gjuhë: shqipe, serbe, turke (përveç udhëzueseve) dhe anglisht. Dizajnimi dhe kualiteti i materialeve ka qenë në nivel të lartë. Të gjitha materialet janë përgatitur në kolor. Printimi i materialeve është bërë në kohën optimale, po ashtu edhe shpërndarja e materialeve është bërë para fillimit të trajnimeve pra, pjesëmarrësit në trajnime kanë pasur materialin me kohë. Po ashtu kualiteti dhe sasia e materialeve ishte në nivel.

### **Formularët**

Dizajnimi i pyetësoreve kishte pësuar ndryshime të theksuara krahasuar me formularët që ishin përdorur në regjistrimet testuese të mëparshme. Pas regjistrimit testues të realizuar në nëntor 2006, pas rishikimit dhe nevojës për disa modifikime që iu është bërë formularëve ata janë finalizuar (me ndryshimet e bëra) nga ana e ESK dhe anëtareve të Komisionit Drejtues në takimet e mbajtura nga 19-23 maj 2008 dhe në takimin e mbajtur ndërmjet datave 9-11 shtator 2008.

Nga puna e realizuar në terren dhe pas futjes së të dhënave në bazën e të dhënave (program) është vërejtur se nuk ka pasur vështirësi në mbledhjen e të dhënave. Në 2 pyetje në të cilat ka pasur lëshime të vazhdueshme (serike) ka nevojë që në të ardhmen të ketë më shumë fokusim të trajnimeve (pyetjet për nivelin e arsimit dhe fertilitetin). Këto pyetje nuk kanë qenë aq të vështira për elaborim nga ana e regjistrueseve me qëllim të marrjes së informatave të nevojshme, gjë që mund të thuhet se regjistruesit nuk i kanë kushtuar kujdes të theksuar këtyre pyetjeve. Andaj, në të ardhmen në këto pyetje ka nevojë të fokusimit të trajnimeve. Në bazë të evalumimit është vërejtur se pyetjet sociale si ato të punësimit mund të reduktohen.

## **Udhëzuesit -doracakët**

Duke u bazuar në kuptueshmërinë e pyetjeve nga ana e regjistrueseve mund të thuhet se udhëzuesit kanë qenë në nivel të lartë, duke marrë parasysh se nuk janë hasur vështirësi në marrjen e përgjigjeve nga ekonomitë familjare përveç në pyetjet e lartëcekuaara. Duke u bazuar në nevojën e rishikimit dhe disa propozimeve nga ana e regjistrueseve, kontrolloreve dhe personelit tjetër (para finalizimit të instrumenteve) ndoshta do të ishte e arsyeshme që disa pjesë nga udhëzimi të reduktohen dhe të përshtaten në gjuhën e zakonshme (më pak statistikore) që përdoret nga popullsia vendëse.

Vlen të theksohet se në këtë regjistrim është përdorur edhe versioni i shkurtuar i udhëzuesit .

## **Hartat**

Në mungesë të të dhënave tjera paraprake si adresave, informacioneve tjera për ekonomitë familjare, numrin e popullsisë dhe numrin e objekteve, hartat kanë qenë instrumentet kyçe që janë përdorur në Regjistrimin Testues dhe ndër elementet kryesore që regjistruesit kanë pasur qasje me detale rreth identifikimit të Qarqeve Regjistruese (zonave të regjistrimit) për secilin regjistrues, identifikimit të objekteve dhe ekonomive familjare. Njëkosisht hartat kanë ndihmuar për të monitoruar ecurinë e punëve gjatë fazës së regjistrimit dhe po ashtu një rendësi të veçantë kanë pasur gjatë fazës së kontrollit në terren.

Formati i hartave ka qenë A1, A2 dhe A3 varësisht nga madhësia e qarkut regjistrues dhe shpërndarja e objekteve ndërtimore dhe tipi i QR urban apo rural. Vlerësimet paraprake për numrin e ekonomive familjare neper QR urbane dhe ato rurale ishin të theksuara. Sipas të dhënave të vitit 2004 ishin rreth 998 ekonomi familjare të vlerësuar, ndërsa janë regjistruar 810 ekonomi familjare (duke llogaritur edhe refuzimet). Andaj, është më se e nevojshme që të këtë një azhurnim të të gjithë territorit të Kosovës

Hartat kanë qenë të bazuara në ortofotot e zhvilluara gjatë vitit 2004 e që janë përdorur nga regjistruesit, kontrolloret mbikëqyrësit dhe të tjerët të cilat kanë ndihmuar në lehtësimin e identifikimit në terrenit.

## **Mostra e përzgjedhur**

Duke marrë parasysh rekomandimet nga raporti i KD<sup>3</sup> në pikën 7 (faqe 3) në pasusin 8 ku thuhej: *duhet të jete një test i dizajnuar me shume kujdes e qe do te jete i përqendruar në grupet e caktuara etnike dhe vendbanime, të cilat duhet zgjedhur në konsultim me Komisionin Drejtues-përfshirë këtu edhe vendimet lidhur me kohën më të përshtatshme për caktimin e mbajtjes së testit.*

ESK kishte përgatitur dy variante të mostrës (së qëllimshme) për zhvillimin e testit të ardhshëm dhe kishte propozuar që regjistrimi testues të zhvillohet në 3 komuna: Prizrenit, Dragashit dhe Lipjanit ku ishin përfshirë ekonomitë familjare që i takojnë

---

<sup>3</sup> Nga Raporti i KD 17-19 korrik,2007

pothuaj të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Ato janë zgjedhur në bazë të një numri faktorësh. Nuk ishin përfshirë komunat të cilat kanë qenë pjesë e regjistrimit pilot 2006. Në bazë të të dhënave që posedon ESK dhe konsultimeve të bashkëpunëtorëve të Zyrave Rajonale të ESK-së mbi shpërndarjen e popullsisë dhe përbërjes së tyre etnike është bërë zgjedhja e komunave, vendbanimeve dhe Qarqeve regjistruese të përfshira në këto zona me qëllim të përfshirjes të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Gjatë takimit të mbajtur nga 9 -11 shtator, 2008 ndërmjet ESK dhe Komisionit Drejtues është propozuar nga ana e KD që të rritet numri i komunave në mostër nga 3 në 5 komuna. KD propozoi që mostra të jetë me shumë reprezentative edhe në aspektin hapësinor kështu, që kërkoi nga ESK ti propozoi edhe tri komuna të mundshme dhe të përzgjidhen 2 prej tyre. Komunat e propozuar ishin: Fushë Kosova, Obiliqi dhe Vushtrria. ESK propozoi që komuna e F. Kosovës të jetë e përfshirë në mostër derisa, anëtarët e KD propozuan që komuna e përzgjedhur të jete ajo e Vushtrrisë. Përfaqësuesit e ESK njoftuan KD se vendbanimi i Mamushes që ishte përzgjedhur në mostër do të jete si komuna e 6-te pasi që nga qershori i vitit 2008 Mamusha ishte komune e ndare nga ajo e Prizrenit. Në tabelën nr. 3 është dhënë *mostra finale* që është pëlqim i përbashkët i ESK dhe KD.

Propozimi i final nga ESK dhe KD - rreth 998 ekonomi familjare

Komuna		Vendbanimet	Qarqet Regjistruese			Etniciteti	Nr. i vlerësuar i ekonomive familjare në QR
Emërtimi	Kodi	Emërtimi	Kodi	Urban	Rural		
Prizren	20	Prizren	212	X		Shqiptar	85
Prizren	20	Prizren	319	X		Rom	117
Prizren	20	Prizren	204	X		Ashkalinj	96
Prizren	20	Shpenadi	365		X	Egjiptas	70
Prizren	20	Sredska	360		X	Serb	59
Prizren	20	Lub.e Epër.	84		X	Boshnjak	71
Mamusha	20	Mamushë	121		X	Turq	70
Dragash	5	Brod	15		X	Goran	37
Lipjan	13	Lipjan	116	X		Shqiptar	93
Lipjan	13	Dobrotin	28		X	Serb	59
Lipjan	13	Skullan	161		x	Serb	59
Prishtina	19	Prishtina	318	X		Shqiptar	77
Prishtina	19	B. Poshtme	13		X	Serb	50
Vushtrri	27	Banjskë	106		X	Shqip & Serb	55
Mostra finale - 6 komuna, 12 vendbanime dhe 14 QR				5	9		998



## **Aspekti Logjistikë**

Koha për përgatitjen e logjistikës së regjistrimit ishte e mjaftueshme dhe në anën tjetër përvoja nga regjistrimet e mëparshme testuese (dhe përvojat nga hulumtimet e rregullta statistikore) ka mundësuar të përgatiten të gjitha aktivitetet në kohën e duhur.

Materialet e nevojshme ishin përgatitur që më parë. Përkthimi ishte bërë në gjuhët e komuniteteve në kohën e duhur (6 ditë para fillimit të trajnimeve) dhe materialet iu ishin shpërndarë në kohë pjesëmarrëseve në regjistrim.

Konkurset për pranimin e regjistrueseve janë bërë nga ana e Komisioneve Komunale të regjistrimit që ishin shpallur në komunat ku do të zhvillohej regjistrimi testues, njëherit KKR kanë bërë edhe përzgjedhjen e regjistrueseve me kriteret që i kishte propozuar ESK. Regjistruesit janë përzgjedhur nga komuniteti i cili fletë gjuhën në QR. Derisa, kontrolloret dhe mbikëqyrësit kanë qenë të përzgjedhur nga ana e ESK.

Secili regjistruer ka pasur materialin e nevojshëm për regjistrim duke përfshirë: kartelat identifikuese, autorizimin, çantat, formularët, udhëzuesit, hartat, fletoret, lapsat, kapelat dhe materialet tjera që janë marrur në ditën e parë të trajnimeve.

Me qëllim të komunikimit më të mirë, ESK ka pajisë me mbushje telefonike (mobile) të gjithë personelin e angazhuar në regjistrimin testues.

Në aspektin logjistikë regjistruesit janë mbështetur edhe me transport privat (pagesat nga ESK), transport të ESK dhe atë nga Komisionet Komunale.

Komisionet Komunale të Regjistrimit ishin në nivel të duhur dhe kishin krijuar kushtet e nevojshme për mirëvajtjen e regjistrimit në komunat e tyre. Pranimi-dorëzimi i materialeve është bërë sipas planit të përcaktuar me herët nga ESK. Pas realizimit të punës së terrenit materiali është dorëzuar nga regjistruesi tek kontrollori i cili më pas ka dorëzuar materialin në lokalet e KKR ku ka qëndruar për një kohë 5 ditësh derisa iu është bërë një kontroll i materialit nga ana e anëtareve të KKR dhe koordinatorëve që kanë përfaqësuar ESK në KKR. Pas ditës së 5 materialet janë kthyer në paketat e destinuar për kthim të materialeve në ESK sipas procedurave të dorëzimit – pranimit të materialit.

Fazat rreth logjistikës iu kanë përmbajtur planit dinamik dhe të gjitha materialet dhe aktivitetet janë kryer në kohën e duhur.

## **Fushata sensibilizuese**

Edhe pse realizimi i Testit ishte në përmasa të vogla, ESK kishte planifikuar të zhvilloi një fushatë të arsyeshme sensibilizuese (edhe me propozimin e KDM). Qëllimi i kësaj fushate ishte që të njoftohen me afër popullsia e atyre QR të cilat ishin përzgjedhur në Test me qëllim që ti ndihmonte të gjithë pjesëmarrësit në regjistrim për të kuptuar me mirë se çfarë është interesi i të gjitha komuniteteve që të marrin pjesë në regjistrim. Njëkosisht nga ky

regjistrim testues nga popullsia e QR te përzgjedhura janë nxjerrur disa te dhëna te dobishme për aktivitet e mëvonshme.

*Këto te nxjerrura do ti ndihmojnë te gjithëve ne fushatën te cilën e ka planifikuar ESK ta realizoj ne regjistrimin e plote.*

ESK ka përzgjedhur një fushat sensibilizimi ne nivel te matshëm. Janë përzgjedhur mjetet e fushatës si: vizita direkte ne terren-komunikimi me Komisionet komunale te Regjistrimit, shtypja e një broshure për te gjithë personat e involvuar dhe për qytetaret tjerë, njoftimi përmes medieve elektronike dhe te shkruara, biseda direkte me qytetar e zonave te përzgjedhura dhe ne fund shpërndarjen e fletëpalosjes për te gjitha ekonomit familjare dhe letrën njoftuese drejtuar familjeve disa dite para regjistrimit. Janë vizituar komunat e përzgjedhura ne test.

**Koha e realizimit të fushatës - Fushata është koncentruar në 5 faza.**

**Faza e pare:** Sensibilizimi i Komisioneve Komunale te Regjistrimit.

Është përgatitur plani dinamik i vizitave nëpër të gjitha komunat qe ishin përzgjedhur ne test. Pasi janë konsoliduar Komisionet komunale te Regjistrimit me pas janë vizituar nga një delegacion i përbërë nga: Kryetari i Komisionit Qendror te Regjistrimit te Popullsisë (njeherit zv. Ministër i MSHP-ke) z.Rifat Blaku, një anëtari tjetër te KQR, Kryeshefit Ekzekutiv te ESK, drejtorit te Zyrës se Regjistrimit dhe një anëtari te sekretariatit te KQR. Po ashtu janë përgatitur disa materiale për ti njoftuar anëtarët e KKR për rolin, detyrat dhe rendësin e regjistrimit Testues. Pothuaj ne te gjitha takimet janë zhvilluar edhe diskutime te ndryshme rrethe këtij regjistrimi testues.

Vizita e pare është bere ne Komunën e Dragashit ku janë pritur nga te gjithë anëtarët e KKR. Me pas është vizituar Prizreni, Prishtina, Lipjani, Vushtrria dhe Mamusha. Vizitat janë bere ne mes te datave 07-10 tetor 2008. Pothuaj ne te gjitha takimet kane prezantuar te gjithë anëtarët e KKR. Ne përbërjen e KKR ne te gjitha komunat ishin përfshirë edhe anëtarët e komuniteteve te ndryshme qe jetonin ne ato komuna.

**Faza e dytë:** përdorimi i mjeteve komunikuese

ESK ka përgatit fletëpalosje ku janë cekur pikat kyçe për regjistrimin testues dhe atë te përgjithshëm, postera duke i njoftuar popullatën se ne zonën Tuaj do te mbahet një regjistrim testues. Posterët janë vendosur neper komisionet komunale dhe neper QR. Janë dhënë dy intervista ne dy radio kombëtare (shqip). Po ashtu disa dite para regjistrimit iu është shpërndarë fletëpalosja tek të gjitha ekonomive familjare si dhe letra njoftuese. Dy dite para fillimit te regjistrimit testues ne terren, nga ana e KQR (kryetari i KQR z. Blaku) ka dhënë mesazh dhe njoftim përmes televizioneve kombëtare për fillimin e regjistrimit testues. Ketë informacion e kane transmetuar edhe emisionet e lajmeve ne gjuhët: serbe, turke dhe boshnjake.

**Faza e tretë:** biseda me qytetar

ESK ka parë si shumë të rëndësishme komunikimin direkt me qytetar në ato zona të përzgjedhura në regjistrimin testues. Andaj, ESK ka organizuar pothuaj në të gjitha QR komunikimin direkt. Disa përfaqësues nga ESK, KQR dhe KKR kane vizituar QR te

përzgjedhura që të diskutojnë dhe të flasin me hapur për regjistrimin. Kjo është vlerësuar si e mirëpritur dhe me ndikim tek komunitetet.

*Faza e katërt* - shpërndarja e letrave njoftuese dhe fletëpalosjeve

Disa dite para fillimit të regjistrimit të gjitha ekonomive shtëpiake iu është shpërndarë letra drejtuar ekonomive shtëpiake të deleguar nga ESK. Po ashtu iu është dërguar një broshurë (fletëpalosje) ku janë cekuar disa karakteristika kryesore të këtij regjistrimi testues.

*Faza e pestë* - dhënia e intervistave të ndryshme neper televizionet kombëtare, lokale dhe ato ndërkombëtare. Që nga data 25 tetor janë dhënë: 5 intervista për televizione nga ana e KQR dhe ESK, janë dhënë informacione pothuaj të gjitha gazetave kryesore të Kosovës dhe ka një konferencë për media të organizuar nga ana e KQR. Fushata ka vazhduar edhe gjatë ditëve të para të regjistrimit me dy intervista nga ana e ESK për media.

Të gjitha instrumentet janë përgatitur në gjuhët: shqipe, serbe dhe turke (posterat, fletëpalosjet, letrat njoftuese dhe në media). Po ashtu gjatë takimeve me qytetar në grupin e përfaqësuesve të cilët kanë folur për rëndësinë e regjistrimit kanë qenë përfaqësuesit e komuniteteve.

ESK ka bërë një fushatë të nivelit mesatar duke marrë për bazë madhësinë e Testit dhe disa karakteristika tjera (mos shpenzimi i mjeteve dhe fokusimi më i madh në biseda direkte). Një fushatë e llojit të tillë që ka bërë ESK është treguar e suksesshme tek të gjitha komunitetet. Njekosisht sensibilizimi i madh do të kishte qenë më shumë kontraproduktiv në disa aspekte pasi popullsia e Kosovës ka bërë pritje të gjata për regjistrimin e përgjithshëm dhe jo një pilot test tjetër. Po ashtu sensibilizimi në një shkallë më të gjerë mund të kishte indikacione tek komunitetet tjera për mos participim.

## **Trajnimet**

Për shkak të numrit të vogël të pjesëmarrësve në regjistrimin testues trajnimet janë organizuar nga ESK dhe janë mbajtur në lokalet e ESK.

Më datë 17 tetor janë mbajtur trajnimet të veçanët për mbikëqyrësit kontrollorët dhe anëtarët e komisioneve komunale.

Për regjistruar trajnimet janë mbajtur nga data 20-24 tetor 2008 (5 ditë) nga ora 10.00-16.00 në lok. e ESK.

Trajnimet janë mbajtur në gjuhën shqipe (derisa materiali për prezantim është përgatitur në dy gjuhë: shqip dhe serbisht) dhe ka pasur përkthim simultan në gjuhët: serbe dhe turke. Në fund të trajnimeve është përgatitur një test për të parë nëse trajnimet kanë qenë në nivel të duhur. ESK në regjistrimin e përgjithshëm do të angazhojë numër të caktuar të trajnuesëve nga komuniteti serb dhe ai turk.

## TI-përfshirja

Departamenti i TI në bashkëpunim me logjistikën sipas planin të hartuar ka testuar aspektet organizative dhe teknike të procesit të futjes së të dhënave, ka kontrolluar dhe monitoruar të gjitha fazat prej inicimit të punës ne terren e deri ne përfundim të procesit dhe ka nënvizuar të gjitha te gjeturat dhe problemet e shfaqura gjatë këtij procesi.

Numri dhe aktorët që kanë qenë të involvuar në proces janë:

- 2 *Expert për Programim*
- 12 *kodues (Nace,Isco,Isched)*
- 2 *Arkivist*
- 10 *Operator*
- 2 *Supervajzer.*

*Procesi është zhvilluar në 6 faza:*

1. *Pranimi, arkivimi dhe kontrollimi i materialit*
2. *Kodimi i pyetësorëve*
3. *Futja e të dhënave për BL1 dhe RS1*
4. *Futja e të dhënave të pyetësorëve R123*
5. *Korrigjimi i gabimeve*
6. *Tabelimi*

**Arkivimi dhe Kontrollimi i Materialit:** Pas përfundimit te procesit në teren dhe kthimit të materialit, me datën 14/11/2008 ka filluar procesi i arkivimit dhe kontrollimit që ka zgjatur 3 dite deri me datën 17/11/2008. Ne këtë faze para se të dërgohet materiali në fazën e përpunimit të të dhënave janë bërë kontrollat logjike nga 2 Arkivist.

**Kodimi i pyetësorëve:** Pas përfundimit të suksesshëm të fazës së parë të arkivimit dhe kontrollimit të materialit, me datën 17/11/2008 ka filluar faza e kodimit me delegimin e Qarqet Regjistruese nga arkivisti tek koduesit. Gjatë delegimit arkivisti ka regjistruar në bazën e të dhënave Qarkun Regjistrues që iu është dhënë kodifikueseve të kodohet duke përdorur programin e Monitorimit të Fazave.

**Futja e të dhënave të pyetësorëve BL1 dhe RS1 (Data Entry):** Pas kthimit të materialit nga terreni shënimet që figurojnë nga pyetësori BL1 që prezantojnë kodin e ndërtesave dhe llojin e banimit në atë ndërtesë brenda 1 QR dhe pyetësorit RS1 që prezanton totalet e banesave, ekonomive familjare, personave, gjinisë etj janë regjistruar në sistem me qëllim që të bëhen disa kontrollime dhe që të sigurohet që gjatë futjes së të dhënave të pyetësorëve R 1.2.3 janë regjistruar ne Sistem të bazës së të dhënave. *Kjo fazë ka zgjatur 1 ditë ku janë përfshire nga 2 operator.*

**Futja e të dhënave të pyetësorëve R1,R2 dhe R3 -** Pas përfundimit të kodimit të te gjitha Qarqeve Regjistruese me datën 21/11/2008 ka filluar futja e te dhënave.

Sistem i futjes se te dhenave i perdorur gjate ketij procesi eshte avancuar dukshmerisht pas "PILOT REGJISTRIMIT TË PARË" që ka mundësuar të identifikohen më mirë kërkesat e sistemit dhe mangesit.

Sistemi pas çdo pyetesori ka implementuar "Verifikimin" e vlerave dhe në rast të identifikimit të ndonjë inkonsistence mes pyetjeve ka kërkuar nga operatori të rifus këto vlera me qëllime që të garantohet që vlerat e shënuara në pyetësor gjithashtu janë regjistruar nga sistemi.

**Performanca e operatorëve:**

- Përfshirja ka zgjatur 5 ditë.
- 752 Ekonomi Familjare janë gjithsej
- Janë futur 150 Ekonomi për një ditë
- Brenda një dite janë përfshirë 15 ekonomi familjare nga një operator
- Mbrenda 1 dite është punuar 5 ore efektivisht.
- 3 ekonomi familjare brenda 1 ore ose 20 min për 1 EF.
- Mesatarisht janë futur 5.6 Pyetësor Individual për 1 EF.

**Rekomandim:** Operatorët duhet t'iu nënshtrohen ndonjë testi që do të jepte një performancë në lidhje me cilësinë e futjes së vlerave të çdo operatori.

**Tabelimi :** Disa tabela të gjeneruara pas përfundimit të procesit, paraqesin numrin dhe llojin e banimit, numrin e personave sipas gjinisë dhe numrin e personave sipas etnicitetit.

Tab1: Numri i banesave të banuara dhe të pabanuara sipas QR					
Komuna	Vendbanimi	QR	Gjithsej	Të Banuara	Të Pabanuara
5	1136	15	49	23	26
13	1242	28	42	39	3
13	1674	116	64	46	18
13	2157	161	45	38	7
19	1080	13	52	38	14
19	2003	318	105	43	62
20	1690	84	108	90	18
20	1766	121	93	67	26
20	2004	204	95	74	21
20	2004	212	122	104	18
20	2004	319	108	91	17
20	2188	360	94	19	75
20	2256	365	83	57	26
27	1038	6	23	23	0
Gjithsej			1083	752	331

Tab 1.2. Numri i Personave sipas Etnicitetit ne Qarkun Regjistrues

Komuna	Vendbanimi	QR	Gjithsej	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Rome	Ashkali	Egjiptian	Goran	Te tjerë	Refuzuar
5	1136	15	106	1	0	12	1	0	0	0	66	23	3
13	1242	28	146	0	143	0	0	3	0	0	0	0	0
13	1674	116	248	230	2	1	1	11	3	0	0	0	0
13	2157	161	135	0	135	0	0	0	0	0	0	0	0
19	1080	13	172	53	119	0	0	0	0	0	0	0	0
19	2003	318	223	217	1	1	4	0	0	0	0	0	0
20	1690	84	451	0	1	447	0	0	0	0	2	0	1
20	1766	121	735	78	1	1	644	10	0	0	0	1	0
20	2004	204	485	392	0	14	0	0	49	19	10	1	0
20	2004	212	559	487	5	4	42	6	0	0	14	1	0
20	2004	319	448	273	0	0	31	136	0	0	8	0	0
20	2188	360	27	0	27	0	0	0	0	0	0	0	0
20	2256	365	359	309	6	0	0	0	23	21	0	0	0
27	1038	6	126	109	17	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>TOTALET</b>			<b>4220</b>	<b>2149</b>	<b>457</b>	<b>480</b>	<b>723</b>	<b>166</b>	<b>75</b>	<b>40</b>	<b>100</b>	<b>26</b>	<b>4</b>

## Monitorimi

Një prej qëllimeve kryesore të monitorimit të regjistrimit testues ishte të përcaktohet nëse regjistrimi do të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të duhur dhe në pajtim me praktikat më të mira statistikore ndërkombëtarisht të njohura, dhe për të vlerësuar nëse infrastruktura dhe kushtet për organizimin dhe zhvillimin e regjistrimit që do të prodhonte rezultate të besueshme dhe të pranueshme janë të avancuara.

Regjistrimi Testues mundësonte që të monitorohen të gjitha fazat e regjistrimit testues, dhe që vëmendje e veçantë t'i kushtohet një numri të madh të aktiviteteve të ndryshme, siç është qartësia e pyetësorëve dhe doracakëve, programit, hartave, përzgjedhja e regjistrueseve, organizimi i trajnimeve, trajtimi i komuniteteve, fushatës sensibilizuese dhe aspekti logjistik.

Për secilën komunë ESK kishte caktuar një person i cili do të monitoronte për se afërmi tërë procesin e regjistrimit. Me kohë ishte përgatitur një *forme unike* e raportimit *ditor* për të gjithë mbikëqyrësit që monitoronin punën në terren. Forma përfshinte nr. e banesave të përfshira, atyre të banueshme dhe jo të banueshme, nr. e ekonomive familjare dhe nr. e personave në ato QR. Në baze të këtyre të dhënave ESK kishte qasje lidhur me ecurinë e mbulimit të regjistrimit në terren. Po ashtu është raportuar për performancën e: KKR, kontrollore, regjistrueseve dhe bashkëpunimi i popullsisë

Takimet e rregullta (ishin caktuar që më parë nga ESK) që mbaheshin çdo ditë në mëngjes nga ora 8.30-9.15 (stafi udhëheqës dhe mbikëqyrësit) ku, mbikëqyrësit informonin për ecurinë dhe dinamikën e procesit të mbulimit në terren.

Planifikimi i tillë mundësoi ESK që të ketë një monitorim shumë të afërt të zhvillimit të procesit në terren me qëllim të marrjes së masave të nevojshme në kohën e duhur siç ishin: nevoja për ndarje të reja të QR, involvimin sipas nevojës të regjistrueseve rezerve, mbulimin me kohë të terrenit, një pasqyre me të qarte lidhur me nr. e objekteve të reja, të shkatërruara, objekteve të banueshme dhe jo të banueshme në QR si dhe rritja e kualitetit të marrjes të informatave të regjistrueseve nga popullsia (*pasi kualiteti i materialit është kontrolluar pas ditës së dytë nga ana e kontrolloreve dhe mbikëqyrëseve-vazhdimisht*). Po ashtu qasja e tillë ka mundësuar që personeli i involvuar në regjistrim të jete me proaktiv gjatë gjithë kohës duke ndërmarr edhe hapat e nevojshëm.

Po ashtu mbikëqyrësit përveç raportimit të mbulimit të terrenit dhe bashkëpunimit të popullatës ata raportonin për kualitetin e të dhënave dhe qeshjet tjera teknike (vijueshmërinë ditore të regjistrueseve në terren, pajisje me material gjatë kohës së punës në terren pasi kishte QR që kërkonim material shtesë, rritja e nr. të regjistrueseve sipas nevojës dhe çështje tjera). Gjatë gjithë kohës sa është realizuar regjistrimi testues në terren ka qene i monitoruar edhe nga Organizata ndërkombëtare që Monitorojnë regjistrimin e popullsisë si dhe nga anëtarët e Komisionit Drejtues Monitorues. Bashkëpunimi ndërmjet personelit të ESK dhe anëtareve të KDM ka qene në nivel të lartë. Po ashtu anëtarët e KDM, kanë pasur qasje në raportet e personelit të ESK që i mbulonin terrenin si dhe ecurinë e aktiviteteve në terren. Në takimet e rregullta që i mbante ESK (çdo mëngjes) në disa takime kishin marrë pjesë edhe anëtarët e KDM.

## **Aktivite tjera - Hapësira punuese dhe azhurnimi dhe GIS**

Për realizimin me sukses të regjistrimit ESK është angazhuar në krijimin e kushteve të nevojshme hapësinore gjë që do të mundësonte rritjen e kapaciteteve sidomos të personelit nëpër grupe punuese si dhe të TI dhe grupin e eksperteve të cilët janë më se të nevojshme në fazat e ardhshme. MSHP dhe KQR iu ka mundësuar ESK marrjen e hapësirës punuese për personelin që do të jete i angazhuar në regjistrim. Kështu, është përzgjedhur hapësira prej 2000m<sup>2</sup> e cila i plotëson kushtet e domosdoshme për realizimin me sukses të aktiviteve të ndryshme. Hapësira është përshtatur nevojave për regjistrim nga një kompani private sipas kërkesës së ESK. Në javën e dytë të dhjetorit është përfunduar puna (sipas kërkesës së ESK) e që nga janari mund të vendoset një numër i konsiderueshëm i personelit.

### **Azhurnim i hartave dhe GIS**

Duke e parë si të domosdoshme azhurnimin e tere territorit të Kosovës, ESK ka kontraktuar një kompani private (kompania e cila kishte përgatitur hartat nga ortofotot e vitit 2004) i cila do të bëjë: digjitalizimin e tere territorit të Kosovës, (me një kualitet shume me të larte se ato të vitit 2004) azhurnimin e rreth 4000 QR që kanë mbetur pa u azhurnuar (1000 QR janë azhurnuar gjate periudhës korrik-shtator 2008) dhe ngritjen e GIS-it për statistika. Projekti është në përfundim të fazës së dyte-azhurnimit, derisa vektorizimi, kodifikimi, ndarje të re të QR do të përfundon në muajin shkurt 2009. Ngritja e GIS do të behet në nga mesi i muajit mars 2009. Pas këtij projekti ESK do të ketë të dhënat e freskëta mbi ndryshimet në terren njëkosisht të një kualiteti me të larte se ato të vitit 2004.

### **Konkluzionet**

Regjistrimi testues në aspektin profesional dhe teknik ka qenë i organizuar në nivel të lartë. ESK ka treguar se ka përvojë e mjaftueshme për organizimin e regjistrimit të përgjithshëm (përgatitjet e regjistrimit testues janë bërë vetëm nga personeli i ESK).

Participimi i popullsisë ishte mbi 93%. Të gjitha komunitetet kishin participuar, gjersa serbët kishin participuar mbi 71%. Nga të gjeturat në terren është mësuar se një pjesë e serbëve do të jenë pjesëmarrës në regjistrimin e përgjithshëm (sidomos serbët që jetojnë në brendësi të Kosovës) edhe përkundër presioneve që mund të vijnë nga Qarqet e ndryshme serbe, njëherit ata janë pjesë e Qeverisë së Kosovës, derisa një pjesë e serbëve mund të mos participonin. Gjatë regjistrimit serbët janë shprehur se nëse atyre nuk do t'iu behej një presion i madh nga Beogradi (e që mund të kenë pasoja në shkurtimin e ndihmave që marrin-sipas tyre) ata do të participonin.

Duke marrë parasysh se regjistrimi i përgjithshëm është një projekt madhor e që kërkon angazhim të theksuar në përgatitjet e nevojshme për regjistrim, kërkohet ti kushtohet një vëmendje e posaçme dhe të përgatitjet me kohë plani detal për realizimin e të gjitha fazave dhe ato të jenë të monitoruara (realizimi i tyre), pasi shume procese janë të ndërlydhura njëra me tjetrën.



Të gjeturat nga regjistrimi testues në *pyetësor, formularë dhe program* te finalizohen që me pare (modifikimet e nevojshme do të merrnin kohë një apo dy javë).

Ti kushtohet një vëmendje e posaçme trajnimeve, derisa kohëzgjatja e trajnimeve në regjistrimin testues ishte në nivel të lartë.

Të angazhohet një numër i caktuar i personelit në fushën e TI, sensibilizimit si dhe fushën e logjistikës rreth pesë (5) muaj para regjistrimit të përgjithshëm.

Te gjitha *materialet* të jenë të gatshme 3 muaj para regjistrimit të përgjithshëm.

Nga ana e KQR te behet ngritja e Komisioneve Komunale të Regjistrimit në kohë 4-5 muaj më parë.

## **Rekomandimet**

Nëse regjistrimi do të mbahet në vitin 2009, Qeveria duhet të marrë vendimin që më parë (shkurt, 2009).

Qeveria duhet të siguroj në kohë ( 5-6 muaj më parë) buxhetin e nevojshëm për mbulimin e të gjitha aktiviteteve.

Nëse do të ketë ndonjë aktivitet në nivel të Kosovës<sup>4</sup>, atëherë duhet të shikohet koha më e përshtatshme për realizimin me sukses të regjistrimit.

Pasi të jetë caktuar data e regjistrimit të përgjithshëm, Qeveria ta ndihmoj ESK me ofrimin e kadrove të reja nga komunitetet ndryshme që jetojnë në Kosovë (sidomos serb dhe turq) që nevojitet një numër i personelit shtesë, pasi trajnimet do të mbahen edhe në gjuhët e këtyre dy komuniteteve.

ESK (pas aprovimit të Udhëzimit mbi pagesën shtesë të personelit të angazhuar në regjistrim) ti fuqizojë grupet e ndryshme si dhe të angazhoj një grup të eksperteve (5-6 muaj më parë) i cili do të ndihmoj në organizimin dhe trajnimet e nevojshme.

Të mbahen takime me shfrytëzuesit e të dhënave para finalizimit të dokumenteve - dy deri tri takime (janar-mars).

KQR- Qeveria të përgatisë një plan rreth përfshirjes së komuniteteve, ngritjen e Komisioneve Komunale të Regjistrimit (*si të veprohet në zonat ku ESK mund të mos ketë qasje*). Pasi regjistrimi i përgjithshëm do të jete i monitoruar nga Organizatat ndërkombëtare, do të ishte e preferueshme që Qeveria të konsultohet me Komisionin Evropian dhe ICO.

---

<sup>4</sup> Nëse do të mbaheshin zgjedhjet lokale, regjistrimi dhe zgjedhjet duhet të kenë minimum një distancë rreth 3 muaj.

## Regjistrimi i përgjithshëm në vitin 2009

Duke u ditur se Kosova ka mungesë të të dhënave statistikore në shumë fusha të ndryshme dhe duke u bazuar në zhvillimet dhe përgatitjet që janë bërë deri më tani për regjistrimin e përgjithshëm dhe nevojës së madhe për të dhëna statistikore me qëllim të krijimit të sistemit statistikor (në të ardhmen) propozojmë që Qeveria e Kosovës të bëjë vendimin dhe të caktojë sa më parë datën e regjistrimit (2009).

Kosova pas një periudhe të gjatë të pritjeve të shumta nga *te gjitha* institucionet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe qytetarët e Kosovës, të shumëpritur dhe shumë të nevojshëm ku, përfitues do të jetë shoqëria kosovare duke filluar që nga komunat, administrata shtetërore vendore si dhe ajo ndërkombëtare, pasi të dhënat statistikore të mirëfillta do të ofrojnë shtetit, administratës dhe publikut të gjere shënime të besueshme për zhvillimet, transformimet dhe ecuritë demografike, ekonomike, sociale, shkallen e punësimit, kushtet e banimit, ato shëndetësore, nivelin e shkollimit, kulturore, arsimore, urbanistike, bujqësore dhe ambientale.

Regjistrimi i popullsisë (ndërkombëtarisht i përfillshëm) sot është edhe një detyrim dhe standard ndërkombëtar ku, një vend nuk mund të paramendojë zhvillimin pa një regjistrim të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare.

Për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, në baze të vlerësimeve nga ana e Qeverisë dhe të Organizatave ndërkombëtare, është vlerësuar se ESK është e përgatitur për një regjistrim cilësor të përgjithshëm të popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave.

Nëse regjistrimi do të mbahej në vitin 2009 nuk ka nevojë të mbahet ndonjë regjistrim tjetër testues, nuk ka nevojë të bëhet azhurnimi i terë territorit të Kosovës (kosto mbi gjysmë milion).

Nëse regjistrimi do të mbahej në vitin 2009, Kosova do të ketë të dhënat e para nga regjistrimi në vitin 2010.

Rritja e kualitetit të të dhënave statistikore do të jete në nivel më të lartë dhe reprezentative për ecuritë socio-ekonomike në Kosovë.

Kosova do të jetë pjesë e komunitetit Evropian të regjistrimeve ku, në vitin 2011 -2012 ESK do të zhvillojë një pilot regjistrim me përmasa të mëdha (sikurse që aplikojnë vendet Evropiane) dhe do të jete pjesë e regjistrimeve duke aplikuar metodologjinë e njëjtë me vendet Evropiane. ESK do të bëjë **vlerësime** për një pjesë të popullsisë e cila mund të mos participojë në regjistrim.

Shtyrja e regjistrimit është duke ndikuar në prolongim i disa projekteve mëdha në ESK, statistikatat janë më pak të besueshme, mungesa e të dhënave reale për varfërinë dhe punësimin në Kosovë, mungesa e të dhënave për gjendjen e kualifikuar e popullsisë, nivelin e shkollimit të popullsisë, kualifikimet, mungesa e të dhënave ndikon në mos

llogaritjen dhe projeksionet e ndryshme të popullsisë si: vitalitetit, shtimit apo rënies të nr. të popullsisë, grupmoshat e popullsisë, shpërndarjen e popullsisë në hapësirë etj.

Mos regjistrimi në kohën sa më shkurtër shkakton pengesa zingjyrore në shumë sfera tjera të shoqërisë duke krijuar edhe vështirësi në strategjitë planifikuese. Vështirësi në planifikimin e projekteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, vështirësi në planifikimet buxhetore në ndarjen e mjeteve nëpër komuna nga ana e Qeverisë. Mungesa e të dhënave krijon edhe vështirësi në planifikimet e investitorëve të ndryshëm.

Po ashtu prolongimi i regjistrimit shkakton kosto të mbajtjes së personelit aktiv dhe largimin e tij, që njëherit është krijuar një bazë e mirë e personelit për realizimin me sukses të regjistrimit.

Mungesa e të dhënave statistikore sjellë kritika të shumta në adresë të ESK nga institucionet dhe individët si: shkencëtarët, hulumtuesit, institucionet etj.